



**Prishtinë: 12.10.2012**

**Kodi i ZRRE-së: V\_482/2\_2012**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_790\_05\_12**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_790\_05\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 14.06.2012.

**Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxorri këtë:**

### **VENDIM**

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin J. S. (shifra në KEK: DPR - 90013484), nga Besiana, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_790\_05\_12 i datës 15.05.2012.

### **Arsyetim**

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 21.01.2011 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 7931080 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 2174987. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar që njehsori elektrik nr. 7931080 ka të këputur një vulë shtetërore, si dhe është kërkuar të dërgohet në qendrën e kalibrimit.

Punëtorët e qendrës së kalibrimit me datë 10.03.2011 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7931080, ku është konstatuar se njehsorit elektrik një vulë (bllombë) shtetërore i mungon kurse dy të tjera i ka të manipuluar, nga ana e jashtme njehsori pjesën kyçëse e ka të djegur si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar ka gjurmë të gërvishtjes të numrave në numëror.

Pas kësaj Departamenti i Faturimit në KEK me datë 20.07.2011 ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar (rikthim i humbjeve) DPR11HP10150 duke e ngarkuar me shumën prej 541.77€. Pas ngarkesës së bërë nga KEK për shfrytëzim të paautorizuar konsumatori ka parashtruar ankesë KEK. Departamenti për Konsumator në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit, ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjegjës nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për bartjen e borxhit të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 15.05.2012 ka nxjerr vendim duke aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkojë konsumatorin me shifër DPR – 90013484 nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) DPR11HP10150 të datës 2007.2011 në vlerë prej 541.77€, si dhe



ka duke kërkuar nga KEK-u ta ngarkoj konsumatorin me korrigjimin vjetër për periudhën 01/2010 deri më 12/2010 bazuar në diferencën mujore prej 64 kWh/muaj (diferenca e shpenzimit të njehsorit të vjetër dhe të ri për periudhat 01/2010 -12/2010 dhe 01/2011 -12/2011).

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 14.06.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_790\_05\_12 të datës 15.05.2012, dhe njëherit ka propozuar që aprovohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar dëshmitë e paraqitur nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit lidhur me falsifikimin e vulave (bllombave) shtetërore (procesverbali i kalibrimit).

Bordi i ZRRE-së ka analizuar vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 055026 të datës 21.01.2011 dhe ka vërejtur se në këtë vërtetim përveç që evidentohet se kanë inspektuar pikën matëse më parë apo jo, si dhe kanë theksuar se përveç njehsorit elektrik vuloset edhe ormani ku gjenden pajisjet (KPO). Bordi ka analizuar edhe procesin e kalibrimit ku theksohet se njehsorit elektrik nr. 7931080 një vulë (bllombë) shtetërore i mungon kurse dy të tjera i ka të manipuluar, nga ana e jashtme njehsori pjesën kyçëse e ka të djegur si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar ka gjurmë të gërvishtjes të numrave në numëror.

Është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike i regjistruar në njehsorin e vjetër nr. 7931080 dhe njehsorin e ri elektrik të vendosur nga KEK-u nr. 2174987. Nga analiza e shpenzimit të energjisë elektrike vërehet se ka rritje të shpenzimit të energjisë me njehsorin e ri elektrik. Për periudhën 01/2010 deri më 12/2010 me njehsorin e vjetër elektrik nr. 7931080 mesatarja e shpenzimit mujorë është 93 kWh/muaj ndërsa për periudhën 01/2011 deri më 12/2011 me njehsorin e ri elektrik nr. 2174987 është 157 kWh/muaj, e që dallimi me mesataren e një viti paraprak është 64 kWh/muaj apo e shprehur në përqindje ka rritje prej 70%. Rritja e shpenzimit të energjisë me njehsorin e ri elektrik nr. 2174987 në krahasim me shpenzimin e energjisë elektrike me njehsorin e vjetër nr. 7931080 nuk është aq e madhe që do të rezultonte se konsumatori ka shkaktuar dëmin e parashikuar nga KEK-u sipas faturës së rikthimit të humbjeve.

Bordi ka analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut ku sipas listave të leximit konstatohet se lexuesi i KEK-ut në asnjë rast nuk ka evidentuar që njehsori elektrik është i dëmtuar në çfarëdo forme përfshi edhe mungesën e vulës shtetërore.

Bordi ka analizuar edhe faturën e rikthimit të humbjeve DPR11HP10150 të datës 20.07.2011 të përpiluar nga Departamenti i faturimit në KEK dhe konstaton se KEK sha ka gabuar pasi që për fatura mujore ka marrë dy vlera të ndryshme, njërën në vlerë 24.51€, ndërsa tjetrën në vlerë 38.92€.

Bordi i ZRRE-së duke i marrë për bazë të gjitha argumentet e theksuara më lart, konstaton se vendimi i DMK-së, është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK-u në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankesë pasi që është shumë e mangët për kah përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_790\_05\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar